# DËSHMI ARKIVI

**A-467591**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ekspertiza për gjurmët e gishtave dhe fijet e flokëve të “Land Rover”-it përfundoi në “Signal” të Agasit |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1393992.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 05:46:48 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 25 shtator 2026, 05:34:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 25 shtator 2026, 05:33:00 UTC → 25 shtator 2026, 05:35:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `890eae77bd10fc712a29eb7b467955eb9132de3f70fa0b5b28b276d38bfcb36d` |
| TEKSTI | `ceee26a9dd2c419eb9b6d9ec63cb55fb0c41d9d11f69d3b5247ced391a907c8b` |
| PAMJA | `ee9d9a1d0faddac31621581259991d2597b1a8c4a1b7d089e41d0def0f7a3146` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4e6aea67e183b434139977a93dcb3851d9d533eba7f6d47311edc3500bed3cae` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `b78e5a58bb99b6139c75653f203f708926b237e838138b6b7709d24a7b49499b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4e6aea67e183b434139977a93dcb3851d9d533eba7f6d47311edc3500bed3cae`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Ekspertiza për gjurmët e gishtave dhe fijet e flokëve të “Land Rover”-it përfundoi në “Signal” të Agasit

Shkruar nga: S. H | Publikuar më: 25.09.2026, 07:34

Share Share



Një akt-ekspertimi për automjetin “Land Rover Defender”, i kryer me kërkesë të SPAK nga Policia Shkencore, dyshohet se ka mbërritur në aplikacionin “Signal” të Ergys Agasit gjatë muajit gusht 2026. Automjeti luksoz, i zi, i sekuestruar më 22 korrik 2026 nga BKH në garazhin e vilës së Agasit pranë kompleksit “Equos Resort”, i ishte nënshtruar ekspertimit daktiloskopik për sigurimin e gjurmëve të gishtave, fijeve të flokëve, si dhe krahasimin me pamjet e një “Land Rover Defender” të përdorur në rrëmbimin e biznesmenit Gerond Meçe.

Pas përfundimit të veprimeve, Policia Shkencore ka hartuar konkluzionet përfundimtare dhe një kopje të aktit i është dërguar SPAK-ut në përgjigje të kërkesës për ekspertim. Megjithatë, disa ditë më vonë, gjatë muajit gusht, tre fletë të këtij akti-ekspertimi dyshohet se janë dërguar nga Fatjon Kalluçi në numrin e përdorur nga Ergys Agasi përmes aplikacionit “Signal”. Sipas të dhënave të administruara në kuadër të hetimit, komunikimi është zbuluar në telefonin e Agasit.

Agasi u arrestua më 26 gusht 2026 në Durrës, ndërsa telefoni i tij u sekuestrua në automjetin me të cilin udhëtonte. Sipas dyshimeve të hetuesve, komunikimet në “Signal” kanë ngritur dyshime se Agasi ishte vënë në dijeni të përfundimeve të ekspertizës së kërkuar nga SPAK përmes punonjësit të Policisë Shkencore, Fatjon Kalluçi. Hetimi vijon dhe, në varësi të provave që do të mblidhen, nuk përjashtohet mundësia e zgjerimit të hetimit dhe e shtimit të akuzave ndaj personave të tjerë, përfshirë Vlora Hysenin dhe zyrtarë të tjerë.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t’i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat

ARTIKULL JOETIK?

TË NGJASHME

Më të fundit




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.